

**FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE
NËNSHKROI NJË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME FAKULTETIN
FILOZOFIK TË UNIVERSITETIT “HASAN PRISHTINA” KOSOVË**

Në datën 10 nëntor 2017, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, të universitetit “Fan S. Noli” u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit me Fakultetin Filozofik të universitetit “Hasan Prishtina” në Kosovë.

Marrëveshja u nënshkrua nga dekanët e të dy fakulteteve, Prof. dr. Gjergji Pendavinji dhe Prof. dr. Bujar Dugolli. Kjo marrëveshje synon realizimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor, zhvillimit të veprimtarive të lidhura me shkëmbimin e stafit akademik, kërkuesve, studentëve etj.



